



UNË NUK JAM MBIKËQYRËS
I FESË, AS PASQYRA E SAJ!



ZOT NA RUAJ NGA PËRÇARJA!



KRENARIA E SHPIRTIT

Viti XVI - Nr. 2 (180),
Shkurt, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

Ngadhënjimi i një qyteti përballë një shteti

Mbas dështimit të përpjekjes së MALAZEZËVE NË kodrat e Bardhajve, MALAZEZËT nisën bombardimin e QYTETIT ME ARTILERI TË RËNDË. INTENSITETI I bombardimeve shtohet gjatë mbrëmjes, me synim jo vetëm për të masakruar popullsinë e Shkodrës, por edhe për të terrorizuar njerëzit dhe dobësuar moralin e të rrethuarve. Njerëzit detyroheshin të kalonin natën jashtë nga frika e predhave.



PËRSE Islami ka porositur për NAMAZIN ME XHEMAT dhe ka obliguar NAMAZIN E XHUMASË?

U rrej që hytbeja të jetë irritim personal, sulm politik, apo komentim i ngjarjeve kalimtare, sepse xhamitë nuk janë ndërtuar për qëllime të tilla. Obligimi i hytbes është ashtu siç ka ardhur në Kur'anin Famëlartë: "Nxitoni për tek përmendja (dhikri) i Allahut", dhe përmendja (dhikri) i kërkuar është lidhja e njerëzve me Zotin e tyre, përmes vështrimit në horizontet e universit dhe çështjeve të njerëzve, sipas asaj që e ka sqaruar Kur'ani Famëlartë: "Do t'ua shfaqim argumentet tona në horizonte dhe në vetet e tyre, derisa atyre t'u bëhet e qartë se ai është i vërtetë." - (Kur'ani, Fussilet: 53)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

“40 HADITHE ME NGA DY POROSI”, OSE: 80 UDHËZIME ME VLERË NGA I DËRGUARI I ALL-LLAHUT

shqipe. Është një risi, që pasqyron më së miri atë, që vetë autori thekson në parathënie e botimit të tij të ri: “Nuk ka dyshim, se pa e njohur jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), apo siç quhet ndryshe në terminologjinë islame, Synetin e tij, nuk mund ta ndjekim e ta pasojmë në vepra, në moral dhe sjellje.”^[6]

Pikërisht, nëpërmjet kësaj vepre të vogël në dukje, lexuesi mund të përfitojë njëherazi 80 porosi të urta nga burimi i urtisë së Hz. Muhammedit (a.s.). Sidomos sot, kur propaganda islamofobe, edhe në gjuhën shqipe dhe në trojet tona, mundohet të bëjë rolin e zhurmuesit dhe penguesit të pamoralshëm para duarve të rinisë dhe masës së gjerë, leximi i këtyre haditheve dhe i këtij model botimesh, mendoj se ka një rëndësi dhe vlerë të madhe në drejtim të pastrimit të imazhit të gabuar të krijuar rreth Islamit, si dhe në drejtim të përfuturit të vlerave reale të fesë sonë, nga burimi i të Dërguarit të All-llahut!

Duke nisur nga hadithi i parë, autori sjell bashkëbisedimin e Resulull-llahut (a.s.) me sahabiun Eshbah Ibnul-Kajs, të cilit, Resulull-llahu (a.s.) i kishte thënë: “Tek ti janë dy cilësi, që i do Allahu: Durimi dhe matura” – (h. 1, f. 11).

Aty mësojmë, se: “... Përcmimi i prejardhjes dhe vajtimi për të vdekurin” – (h. 2, f. 13), janë veçori të femohimit, që nuk lidhen me sjelljen, traditat dhe kulturën fetare të muslimanit!

“Shëndeti dhe koha e lirë” – (h. 3, f. 15), në sytë e Resulull-llahut (a.s.) janë “dy begati”, në të cilat shumë prej njerëzve janë të mashtruar a të humbur, në raport me shfrytëzimin e tyre, si e sa duhet.

Aty mësojmë, se: “...Një njeriu, që Allahu i ka dhënë pasuri dhe e shpenzon atë në të drejtën dhe, një njeriu tjetër, që Allahu i ka dhënë Urtësinë (Kur’anin) e ai gjykon me të dhe ua mëson të tjerëve” – (h. 4, f. 17), janë njerëz për t’u pasur zili për mirë, sepse, në të vërtetë ta janë ndërtues vlerash në shoqëri. Si të thuash, Hz. Muhammedi (a.s.) po na udhëzon drejt përsosmërisë, në formë e mënyra të ndryshme legjitime!

Autori, sjell edhe transmetimin e Imam Muslimit, prej të cilit mësojmë, se Resulull-llahu (a.s.) ka specifikuar pasurinë dhe jetën, si të shumëdëshiruara nga njeriu: “Lakmia për pasuri dhe lakmia për të jetuar” – (h. 5, f. 19).

Aty do të gjejmë edhe disa prej shenjave të kijametit, për të cilat na ka lajmëruar i Dërguari i All-llahut. “Njerëz që me vete kanë kamzhikë si

**“PREJ VEÇORIVE MË
TË SPIKATURA TË YMETIT
MUHAMMEDAN, ËSHTË
EDHE SPECIFIKA E ISNADIT
NË PËRCJELLJEN E SHERIATIT
TË PASTËR DHE DIJEVE
TË TIJ NGA TË PARËT TEK
TË MBRAMËT. ISNADI ISHTE
KUSHTI I PARË NË ÇDO DIJE
TË TRANSMETUAR...”**

bishtat e lopëve, me të cilët qëllojnë njerëzit dhe, gra të veshura lakuriq, që përdridhen e ekspozohen” – (h. 6, f. 21), si një tërheqje vëmendjeje për t’u ruajtur nga zullumet dhe imoraliteti në shoqëritë njerëzore.

Resulull-llahu (a.s.) thotë: “Turpi është prej besimit” – (h. 7, f. 23), si për ta vulosur me mirësi e virtyt, sjelljen dhe moralin e muslimanit dhe muslimanes në përditshmërinë e tyre!

Aty mësojmë korrektësinë dhe disiplinën me oraret e ndryshme, si dhe respektin dhe nderimin ndaj prindit: “Më e mira e punëve, (ose e punës) është: Namazi në kohën e tij dhe mirësjellja ndaj prindërve” – (h.

8, f. 25). Sepse, një njeri që disiplinon jetën e tij me faljen e namazit pesë herë në ditë, në orare fikse, natyrshëm që do të jetë një individ i vëmendshëm ndaj kohës së tij dhe shfrytëzimit të saj. Njëkohësisht, respekti ndaj prindit dhe shfaqja e tij, pa mungesë modestie, mbetet një ndër veçoritë karakteristike të muslimanit!

“Atëherë, mos e shtrij dorën tënde, vetëm se në të mirë dhe mos thuaj me gjuhën tënde, vetëm se mirë!” – (h. 9, f. 28), është një ndër urtësitë e spikatura të Hz. Muhammedit (a.s.), nëpërmjet të cilës mësojmë dinjitetin dhe krenarinë, pastërtinë e gjuhës dhe integritetin e personalitetit të muslimanit në jetë.

Dikush e pyeti Resulull-llahun (a.s.): Kush prej njerëzve është më i mirë? Tha: “Çdokush që e ka zemrën të dliër dhe gjuhën të singertë” – (h. 10, f. 29). Ky është një udhëzim që vlen sa njëmijë fjalë dhe që ka një mirësi të madhe, që i sjell njerëzimit paqe dhe bekim!

Kështu, në krejt faqet e këtij botimi të ri, përgjatë leximit dhe komenteve të 40 haditheve, është e pamundur të mos përfitojmë diçka të re, që na shërben për të sotmen dhe të ardhmen tonë, në rrugën e përsosjes së marrëdhënies sonë me fenë dhe traditat e të Dërguarit të All-llahut!

Autorin e falënderoj që na mbledhi për këtë mirësi të madhe dhe këtë botim të ri, që natyrshëm i shtohet librotekave tona, duke i pasuruar ato.

Uroj dhe lutem, që teologët dhe thirrësit islamë të Shkodrës, por jo vetëm, të vazhdojnë të prodhojnë vlera, për të cilat kemi kaq shumë nevojë dhe të cilat, na shërbejnë për të rrugëtuar të sigurtë drejt kerkimit të pëlqimit të Zotit në jetën tonë.

Urime dhe suksese!

(Fjala e mbajtur në promovimin e librit: “40 hadithe me nga dy porosi”, Shkodër, më 9 shkurt 2018)

[1] Shejkh Abdulfettah Ebu Guddeh, “El-Isnadu mined-din”, botimi i parë, Damask, 1992, f. 11.

[2] Po aty, f. 1.

[3] Imam Bedruddin El-Ajni, “Sherh Sahihul-Bukhari”, botimi i dytë, Liban, 2009, vëll. 1, f. 19.

[4] Po aty, f. 19.

[5] Po aty, f. 21.

[6] Lavdrim Hamja, “40 hadithe me nga dy porosi”, Shkodër, dhjetor 2017, f. 9.

UNË NUK JAM MBIKËQYRËS I FESË, AS PASQYRA E SAJ!

Nuk përkufizohet Islami në veprimet e mia, as në sjelljen time, as në dijen a preferencat e mia intelektuale! Nëse ndonjëherë keni kuptuar të kundërtën e saj në fjalët a shkrimet e mia, ju kërkoj shumë ndjesë!

Islami është feja e Zotit, dini i All-llahut, paketa më e sigurt për udhëzimin e njeriut në jetë, ndërsa unë e ju jemi njerëz dhe, njeriu është i mangët, i gabueshëm!

Për këtë, tek ne në Islam, feja konsiderohet rregullator i jetës, ndërsa besimtari ftohet të jetë shembull i saj, pasqyrim i vërtetësive të saj në moral e sjellje, në mendime e ndjenja, në dituri e përparim dhe përtej tyre, duke u disiplinuar me rregullat e saj, duke respektuar vijëzimet e rrugës së gjatë...

Fakti që të dërguarit e All-llahut ishin njerëz, pasqyron më së miri, se feja ka një rol të pazëvendësueshëm në edukimin dhe disiplinimin e jetës së njeriut, sipas hartës më të saktë të edukimit dhe udhëzimit të saj, që Zoti shpalli për njerëzimin, për të mos e lënë atë në dorë të egos dhe kapaciteteve të ngushta, në përmasat e të cilave, e krijoi!

Por, ndodh që njeriu, për një arsye a një tjetër, të humbasë ekuilibrin, të gabojë, të hutohet, të bëjë gjynah, të bie në batakun e egoizmit, mendjemadhësisë, vetëkënaqësisë e arrogancës. Në këtë rast, assesi nuk

duhet marrë për bazë e t’i llogaritet fatura e lëkundjeve të tij, fesë!? Nëse reflekton dhe pendohet, Zoti e faltë dhe e mëshiroftë. Nëse jo, Zoti e shëroftë, se është i sëmurë rëndë! Ndërsa feja, feja mbetet qelibr, e paprekur, e papërlyer!

Feja qëndron mbi njeriun! Njeriu që disiplinohet me fenë dhe dëshmohe si “Kur’an i gjallë”, që lëviz mbi tokë, dëshmon mrekullinë e saj në jetën tonë. Por, as ky lloj njeriu, as ndonjë tjetër, kurrsesi nuk ka, as mund të ketë të drejtë ta konsiderojë veten si mbikëqyrës i fesë, i Thirrjes Islame, i institucioneve fetare e përtej tyre! Njeriu është kalimtar, feja jo, nuk vdes as shuhet me njerin a tjetrin, as shuhet me dhunimin, cënimin, shpifjen a trillimin, luftën a përpjekjet kundër saj!

Unë nuk jam mbikëqyrës i fesë, as pasqyra e saj! Kjo fé dhe kjo Thirrje qëndrojnë mbi mua dhe përtej meje! Unë fisnikërohem duke i shërbyer me sa të kem mundësi, forcë e jetë!

Ato bëjnë edhe pa mua, njësoj si çdo institucion ku mund të kem punuar, a aktual i ku vazhdoj të shërbej! Kjo është një mesele, që vlen t’ia kujtojmë shpesh vetes, më së paku!

All-llahumme na bëj çelësa të së mirës, drynj të së keqes dhe na mbro nga intrigat e kësaj bote kalimtare dhe batakun e egoizmit, mediokritetit!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 7 shkurt 2018





Sheikh Muhamed El-Gazali

PËRSE ISLAMI KA POROSITUR PËR NAMAZIN ME XHEMAT DHE KA OBLIGUAR NAMAZIN E XHUMASË?

fitojnë, vetëm se konflikt iluzionist, shkatërrim pas një mirazhi që shkëlqen dhe që nuk ka shpëtim prej tij!

Islami ka këshilluar për të shkuar në xhami pesë herë në ditë dhe myslimanët e kanë zbatuar këtë gjë, derisa Ibn Mes'udi thoshte: Na shikoje neve, saqë askush nuk e linte namazin, veçse ndonjë munafik (hipokrit) që njihej për hipokrizinë e tij, ose ndonjë i sëmurë. Ibn Mes'udi ka thënë: I dërguari i Allahut na ka mësuar sunetet e udhëzimit dhe prej suneteve të udhëzimit është namazi në xhaminë që thërritet ezani.

Namazi është pjesë e aktivitetit islam mbi çdo pëllëmbë toke ku jeton Islami dhe xhamia është tipari i parë i qytetërimit islam në çdo fshat dhe qytet. Kur besimtarët të korrin sukses në ndërtimin e shoqërisë së tyre, larg prej nënçmimit të provokatorëve dhe mashtrimit të jobesimtarëve, atëherë ndërtimi i parë që mendojnë për të dhe nxitojnë drejt tij, është falja e namazit, si përgjigje e ajetit: “Të cilët, kur Ne i mundësojmë në tokë, e falin namazin, e japin zekatin, urdhërojnë për mirë dhe ndalojnë nga e keqja.” - (Kur'an, El-Haxh: 41) Disa u përpoqën të hynë në Islam, duke kërkuar të lehtësohen prej namazit, por i Dërguari refuzoi rreptësisht duke thënë: “Nuk ka mirësi në një fe pa namaz”.

Kur'ani Famëlartë na tregon se, qytetërimet që u zhdukën dhe ato, në të cilat u thanë burimet shpirtërore, e mbizotëruan mbi ta epshet materiale dhe u shkëput me Allahun lidhja e tyre, u ndërpre bereqeti i Tij! Allahu i Madhëruar, në përshkrimin e brezave të shkuara thotë: “E pas tyre erdhën pasardhës, që e humbën namazin dhe pasuan epshet, e do të shijojnë humbjen.” - (Kur'an, Merjem: 59)

Lidhja e dëlirësisë dhe e drejtësisë me namazin është e kuptueshme dhe shtimi i zjarrit epshëror me largimin nga Allahu është realitet, e qytetërimet e zhytura në materializëm nuk do të

idhujtarët dhe hipokritët në tallje të fesë së re dhe sharje të dispozitave të saj? Zhytja në mosbesim dhe sfidim!

Pejgamberi (a.s) e urreu, që Islami të ndeshet me këtë tallje, e dispozitat e tij me këtë kotësi dhe që hipokritët të gjenin mbështetje, në mesin e jobesimtarëve duke i ndihmuar ata të fyenin myslimanët me këto mënyra të ulëta, prandaj dhe dërgoi këtë paralajmërim, jehona e të cilit arriti deri te njerëzit, e ua prishi rehatinë e gjumit, tha: “Më vjen ndërmend të urdhëroj për namaz e të fillojë të falet, të urdhëroj dikënd që tu priket në namaz njerëzve, pastaj të dal me disa njerëz, që mbajnë pishtarë e të shkoj tek ata që nuk prezantojnë namazin e tua djegë shtëpitë e tyre”. Prandaj, dhe namazi më i rëndë për hipokritët, ishte namazi i jacisë dhe i sabahut! Nuk ka dyshim se, ata janë të nënkuptuar në kërcënimin e mësipërm, sepse çifutët dhe të krishterët, nuk janë të obliguar me namaz.

Kuptimi i hadithit nuk është që t'i tubojë njerëzit për namaz me kërcënim, kjo është e pamundur, sepse masat e besimtarëve, në kërkim të kënaqësisë së Allahut, shkonin me nxitim në xhami, sa herë që dëgjonin ezanin dhe shpresa e tyre ishte kursimi i shpërblimit të madh tek Allahu. Ibn Mes'udi thoshte: “Edhe i sëmuri shkonte, duke e mbajtur përkrahësh deri në xhami dhe njerëzit më të largët ecnin duke shpresuar që çdo hap të shkruhej tek Allahu, e kujdeseshin në rregullimin e safeve (rreshtave)”.

Por, është në të drejtën e besimtarëve, ndërkohë që po falet një namaz me xhemat në përgjithësi, që të mos tubohet xhemat tjetër kot, të mos krijohen tubime serioze, apo dëfryese dhe të mos bëhet tregti për zhurmë.

Njerëzit e kishin vënë re se, kur ngriheshin komisione bisedimesh për

Çfarë ishte ajo, që i bashkoi çifutët,

paqe mes egjiptianëve dhe çifutëve, çifutët zgjidhnin ditët e xhuma për negociata, sikur ata e bënë me qëllim prishjen e kohës së xhumasë dhe humbjen e dispozitave të saj!

Kërcënimet për tallësit dhe përqeshësit me djegie të shtëpive, ka lënë gjurmët e tij, e nuk është transmetuar absolutisht asgjë prej Profetit (a.s), apo kohës së Kalifëve Rashidinë, që të ketë ndodhur diçka e tillë. Keqkuptimet e këtij kërcënimi i kemi shpjeguar, siç ka ardhur në Librin Famëlartë, prandaj nuk ka vend për frikësim e të thuhet se Islami urdhëron të digjen ata që mungojnë në namaz.

Umu Derda transmeton, se hyri tek unë Ebu Derda, ndërkohë që ai ishte i zemëruar dhe i thashë: “Çfarë të ka zemëruar?” Tha: “Pasha Allahun, nuk di asgjë prej ymetit të Muhammedit (a.s), përveç se ata falen të tërë”.

Enesi transmeton, se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Unë hyj në namaz dhe kam dëshirë ta zgjas atë, dëgjoj të qarat e fëmijës dhe shpejtoj në namaz duke e shkurtuar, duke ditur se sa dhembshuri ka nëna për të qarët e tij”.

Umu Seleme transmeton se Pejgamberi (a.s) pasi jepte selam në namaz, qëndronte për pak çaste dhe mendonim se, Allahu e di më mirë, qëndronte në mënyrë që gratë të largoheshin përpara se burrat të dilnin”.

Ebu Hurejra (r.a) transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Safat (rreshtat) më të mirë për burrat janë safi (rreshti) i parë dhe më i keqi i tyre është i fundit, ndërsa safat (rreshtat) më të mirë për gratë janë të fundit dhe më të këqijtë e tyre janë të parët”. Siç duket, cilësimi për keq është për atë që mundohet të përzihet mes dy gjinive! Ndërsa, atij që nuk i shkon në mendje asnjë dyshim, për të nuk ka gjynah, qëllimi është krijimi i ambientit të dëlirë dhe të devotshëm në xhami.

Këto transmetime të pakta prej një shumice sunetesh, që tregojnë se xhamia priste mbarë ymetin dhe largimi i grave prej saj, nuk është njohur tek selefi (brezi) i parë i ymetit, madje shpirti i xhamisë dhe kultura e saj rridhnin përgjatë rrugëve dhe brenda shtëpive.

Nëse xhemati për pesë vaktet e namazeve është sunet i fortë (muekkede), atëherë prezenca në xhuma është farz (obligim) individual për çdo mysliman të aftë. Allahu i Madhëruar thotë: “Kur të thirret për namaz në ditën e xhuma, nxitoni për në përmendjen (dhikrin) e Allahut dhe lini shitblerjen. Kjo është më e mirë për ju, nëse jeni besimtarë.” - (Kur'an, El-Xhumua: 9)

KUR'ANI FAMËLARTË
NA TREGON SE, QYTETËRIMET QË
U ZHUKËN DHE ATO,
NË TË CILAT U THANË BURIMET
SHPIRTËRORE, E MBIZOTËRUAN
MBI TA EPSHET MATERIALE
DHE U SHKËPUT LIDHJA E TYRE
ME ALLAHUN, U NËDËRPRE
BEREQETI I TIJ!

Abdullah ibn Amër transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Xhumanë e prezantojnë tre lloj njerëzish: Një njeri që vjen kot, atij aq i takon prej saj. Një njeri që vjen për tu lutur, ai është një njeri që i ka bërë dua Allahut, nëse do ia jep, e nëse do nuk ia jep. Dhe, një njeri tjetër që vjen në heshtje dhe në prehje, nuk shkapërcen mbi kokat e besimtarëve dhe nuk bezdis askënd, ajo për të është pastrim deri në xhumanë tjetër dhe shtesë tre ditë. Allahu i Madhëruar thotë: “Kush vjen me një të mirë, atij i takon dhjetë të tilla si ajo.” - (Kur'an, El-Enam: 160)

Ali ibn Ebi Talib (r.a) ndërkohë që po mbante hytbe në minberin e Kufes tha: “Kur është dita e xhuma, shejtanët dalin në mëngjes me flamujt e tyre nëpër tregje dhe i spërkasin njerëzit me pengesa, duke e penguar njeriun prej punës së tij dhe duke e larguar prej obligimit, e i ndalojnë prej xhumasë. Dhe, Melekët dalin herët e ulen në dyert e xhamive, shkruajnë atë njeri që vjen në orën e parë dhe atë njeri që vjen në orën e dytë, derisa të dalë imamë. Nëse njeriu zë vend, prej ku mund të dëgjojë dhe shikojë, heshtë dhe nuk bën gjëra kot, ka shpërblim dy secape të mëdha. Nëse mënjanohet dhe zë vend ku nuk dëgjon, heshtë dhe nuk bën veprime kot, ka shpërblim një sevap. Nëse ulet e zë vend, prej ku mund të dëgjojë dhe shikojë, bën veprime kot dhe nuk heshtë, ka ndëshkim dy gjynahe. E, nëse zë vend, prej ku nuk mund të dëgjojë dhe shikojë, bën veprime kot dhe nuk heshtë, ka ndëshkim një gjynah. Dhe, kush i thotë shokut të tij ditën e xhuma: Hesht, ai ka fol kot, e kush flet kot, ai nuk ka prej xhumasë së tij asgjë (prej sevapit)”. Pastaj në fund të hytbes së tij tha: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ta thotë këtë”.

Xhumaja është dispozitë që ia kalon

aparateve më të mëdha të propagandës, tek të cilat ka arritur bota. Nëse myslimanët janë sot një miliard banorë, atëherë supozohet që të mbajnë çdo javë një milion, apo dy milion hytbe! Del njeriu dhe flet përpara njerëzve me Emrin e Allahut, flet atë që ka për të folur e besimtarët heshtin dhe dëgjojnë me vëmendje çfarë thotë. Askush e largon vëmendjen prej tij dhe nuk largohet prej vendit, derisa ta dëgjojë komplet hytben e të falë namazin e xhumasë.

Një ymet i tillë me këtë rregull, duhet patjetër të jetë i unifikuar në pamje dhe në formë, të rritet niveli i tij intelektual dhe emocional, e t'i anashkalojë shkaqet e ndarjes dhe të përçarjes.

Urrej që hytbeja të jetë irritim personal, sulm politik, apo komentim i ngjarjeve kalimtare, sepse xhamitë nuk janë ndërtuar për qëllime të tilla. Obligimi i hytbes është ashtu siç ka ardhur në Kur'anin Famëlartë: “Nxitoni për tek përmendja (dhikri) i Allahut”, dhe përmendja (dhikri) i kërkuar është lidhja e njerëzve me Zotin e tyre, përmes vështirimit në horizontet e universit dhe çështjeve të njerëzve, sipas asaj që e ka sqaruar Kur'ani Famëlartë: “Do t'ua shfaqim argumentet tona në horizonte dhe në vetet e tyre, derisa atyre t'u bëhet e qartë se ai është i vërtetë.” - (Fussilet: 53)

Zgjatja e hytbes nuk është e duhur e as e obliguar. Ebu Vail tregon se, Ammar ibn Jasir na mbajti hytbe, shkurt dhe saktë, e kur zbriti i thamë: Ke mbajtur saktë dhe shkurt, sikur të kishe marrë pak frymë (ta kishe zgjatur)! Tha: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s) duke thënë: “Zgjatja e namazit të njeriut dhe shkurtimi i hytbes, janë shenja të të kuptuarit të tij, prandaj shkurttojeni hytben dhe zgjateni namazin”.

Pjesa më e madhe e hytbeve të të Dërguarit të Allahut kanë qenë Kur'an Famëlartë, për këtë arsye nuk janë mësuar përmendësh hytbe prej ligjëritit të tij (a.s), përveçse pak. Ummu Hisham bint Harithe ibn En-Nu'man thotë: “Nuk e kam mësuar përmendësh “Kaf. Pasha Kur'anin Famëlartë”, veçse nga goja e të Dërguarit të Allahut (a.s) ditën e xhuma”. E lexonte atë në minber çdo ditë xhumaje... Pas hixhretit të Pejgamberit (a.s), llogaritet, se ai ka mbajtur rreth pesëqind hytbe xhumaje.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja





Dr. Ardian Muhaj, *historian*

MBROJTËSIT E SHKODRËS, 1912 - 13

Më 8 tetor 1912 shteti i vockël i Malit të Zi, me një popullsi jo më shumë se 250 mijë banorë i shpallte luftë Perandorisë Osmane. Natyrisht projekti dhe synimi i Malit të Zi ishte jo lufta kundër kësaj perandorie por kundër territoreve shqiptare. Mali i Zi synonte që pas marrjes së shpejtë të Shkodrës të arrinte të pushtonte Prizrenin përpara se këtë ta bënte Serbia. Mirëpo punët nuk shkuan aspak sipas planeve shoviniste malazeze. Shkodra që pritej se do pushtohet shumë shpejt, e shumta një muaj u bë pengesë e pakapërcyeshme për orekset e tyre shoviniste.

Sulmi i Malit të Zi mbi Shkodrën shënoi edhe nisjen e Luftës Ballkanike. Nga sulmi mbi Tuz më 9 tetor, malazetët përparuan duke shkelur me zjarr e hekur, duke vlarë njerëz të paarmatosur dhe duke djegur shtëpi e deri edhe pemë e të korra. Më 11 tetor ushtritë malazeze mbërritën deri në Zogaj në breg të Liqenit të Shkodrës mbasi u kishin vënë flakën fshtatrave njëri pas tjetrit. Menjëherë nisi kriza humanitare e refugjatëve dhe të zhvendosurve. Popullsia e kërcënuar e fshatrave u grumbullua në qytet ku fatmirësisht përveç forcave mbrojtëse nën komandën e valiut Hasan Riza Pasha, vetëm pak kohë më përpara më 3 tetor kishin mbërritur edhe forcat vullnetare e rezerviste nën komandën e Esat Pashë Toptanit prej rreth 6 mijë vetash nga Durrësi, Kavaja, Tirana, Kruja dhe Shijaku. Këto forca ushtarake bashkë me luftëtarët e qytetit e të fshatrave u përgatitën për organizimin e mbrojtjes së qytetit dhe evitimin e masakrave malazeze.

Kriza humanitare u shpalos me shpejtësi të madhe. Numri i popullsisë të fshatrave që drejtoheshin drejt qytetit shtohet vazhdimisht ndërkohë që forcat malazeze përparonin duke masakruar popullsinë civile dhe duke djegur e shkrumbuar fshatrat shqiptare. Në fund të tetorit malazetët tashmë e kishin

NGADHËNJIMI I NJË QYTETI PËRBALLË NJË SHTETI (Rrethimi i Shkodrës - tetor 1912 - prill 1913)

rrethuar edhe qytetin duke u pozicionuar në fushën e Shtojit dhe madje kishin kaluar edhe lumin e Kirit dhe më 29 tetor pozicionohen edhe në kodrat e Bardhajit. Shkodra ishte e rrethuar nga të gjitha anët tashmë. Ndërkohë numri i të vlarëve mbërriti shumë shpejt në mijëra dhe po ashtu me mijëra ishin të plagosurit. Këtyre u shtoheshin edhe tre mijë shqiptarë nga fshatrat e Shkodrës që mbaheshin robër në Podgoricë. Mbas dështimit të përpjekjes së malazezëve në kodrat e Bardhajve, malazetët nisën bombardimin e qytetit me artileri të rëndë. Intensiteti i bombardimeve shtohet gjatë mbrëmjes, me synim jo vetëm për të masakruar popullsinë e Shkodrës, por edhe për të terrorizuar njerëzit dhe dobësuar moralin e të rrethuarve. Njerëzit detyroheshin të kalonin natën jashtë nga frika e predhave.

Malazetët kishin shpresuar se Shkodra e rrethuar nuk do t'i bënte

do të ndodhte muaj më vonë dhe kur përpjekja epike e banorëve të Shkodrës me rrethina, e forcave ushtarake osmane dhe e forcave vullnetare nga zonat e tjera të Shqipërisë do të ndryshonin gjithçka, duke i detyruar Fuqitë e Mëdha që të pranojnë verdiktin e shkruar me gjak e vujtje dhe Shkodra do t'i mbetej shtetit të cunguar shqiptar. Nga fundi i dhjetorit një raport nga ambasadori austriak në Cetinë, pohonte se “qëndresa e paepur për mbrojtjen e Shkodrës ishte jo vetëm rezultat i armëve turke, por edhe një shembull i vendosmërisë me të cilën luftojnë shqiptarët për të mos e dhënë këtë qytet”.^[2]

Ndërkohë që Shkodra nuk jepte shenja dobësie, të gjitha qytetet e tjera shqiptare kishin rënë apo binin njëri pas tjetrit në duart e forcave pushtuese ballkanike. Ndërkohë që malazetët ishin ndalur nga Shkodra, serbët kishin



ballë shtetit të tyre dhe fuqitë e mëdha duke parë këmbënguljen e malazezëve për të marrë Shkodrën, ishin tashmë të bindura se Shkodra duhej t'i jepej Malit të Zi. Megjithatë qëndresa epike e të rrethuarve, nën udhëheqjen e Hasan Riza Pashës dhe Esat Pashë Toptanit, solli ndryshimin e kahut të historisë dhe njëkohësisht edhe ndryshimin e vendimit të Fuqive të Mëdha.^[1]

Kaq lehtë ishte shpresuar të pushtohet Shkodra sa që në fillim të nëntorit malazetët po bënin përgatitjet e fundit për ceremoninë e hyrjes triumfale në qytet. Ishin përgatitur uniformat festive, banderolat e flamujt, madje edhe banda muzikore kishte nisur provat. Por kjo

përparuar me shpejtësi të pandalshme në Kosovë, dhe mbasi kishin marrë Gjakovën e Prizrenin, të cilin e synonin malazetët, kishin zbritur me shpejtësi drejt Lezhës e Shëngjinit. Lezha e Shëngjini u sulmuan më 18 tetor dhe mbas një lufte të ashpër, i morën një ditë më pas më 19 nëntor. Forcat serbe vazhduan drejt Durrësit të cilin gjithashtu e pushtuan me shpejtësi disa ditë më vonë. Shkodra tashmë ndodhej e rrethuar nga të gjitha anët, pa asnjë mundësi komunikimi me zonat e tjera dhe nën zjarrin e kombinuar të malazezëve dhe serbëve.

Ky izolim total i qytetit u jepte forcave pushtuese një aleat shumë të rëndësishëm që ishte mungesa e ushqimeve dhe

ilaçeve për të kuruar të plagosurit dhe të sëmurët. Nga fundi i janarit u mbyllën edhe dyqanet e fundit ushqimore, dhe filloi një periudhë zie buke e padëgjuar.

Me 30 janar 1913 si pasojë e një atentati vdes Hasan Riza Pasha. Ata që e vranë, bashkë me planin për vrasjen kishin përgatitë edhe alibinë për të fshehur fajtorët dhe për të shumëfishuar efektet e vrasjes përmes nxitjes së përçarjes mes shqiptarëve, që vazhdon edhe sot. Çudia më e madhe, është se përgjatë gati një shekulli, janë përfolë shumë teori e alibi për vrasësit dhe arsyet e vrasjes, por askush nuk ka fajësuar malazetët që bombardonin ditë natë me artileri të rëndë Shkodrën dhe që kishte masakruar fshatrat e krejt zonës së Shkodrës.

Pas vrasjes së Hasan Riza Pashës nga dora malazeze, nga ata që kishin kërkuar dorëzimin e qytetit tek Mali i Zi akoma pa filluar rrethimi, drejtimin e qytetit të rrethuar e mori Esat Toptani. Malazetët kishin shpresuar se mbasi arritën të vrasin Hasan Rizain, do të vrisnin edhe qëndresën e të rrethuarve, por ndodhi e kundërta. Pa kaluar disa ditë filloi periudha më e vështirë e rrethimit dhe lufta më e përgjakshme e përballjes. Më 5 shkurt Esat Toptani u kishte thënë jo propozimeve malazeze për dorëzimin e qytetit. Më 7 shkurt malazetët filluan mësymjen e përgjithshme. Bombardimet e pandërprera për orë të tëra të artilerisë u pasuan me sulmin e forcave ushtarake në llogoret e fushës së Shtojit, ku qëndresa ishte aq e fuqishme sa që për një gjysmë ore pushtuesit malazetëzë humbën 400 ushtarë. Në anën tjetër 10 mijë forca ushtarake pushtuese sulmuan llogoret e linjës së mbrojtjes në Bardhaj. Në anën perëndimore të qytetit ra në duart e armikut Shiroka. Në fund të asaj dite të paharrueshme, por të harruar, në të gjitha frontet që u sulmuan, shqiptarët ia dolën t'u shkaktojnë humbje të padëgjua forcave pushtuese. Ushtria shqiptare dhe osmane nën komandën e Esat Toptanit pati 700 të vlarë dhe njëmijë e shtatëqind të plagosur. Malazetët kishin humbur shumë më tepër ushtarë sepe luftonin në terren të zbuluar dhe nuk ia dolën të merrnin asnjë pikë strategjike.

Akoma më të ashpra luftimet u zhvilluan në ditët në vijim. Më 8 shkurt artileria e rëndë e bombardoi pa pushim qytetin dhe malazetët ia dolën të marrin linjën e jashtme të llogoreve të Bardhajve, duke e paguar shumë shtrenjtë. Qindra të vlarë e të plagosur për një avancim minimal në vijën e frontit. Më datën 9 shkurt ishte radha e forcave serbe të pozicionuara në jug të qytetit për ta

provuar dështimin e merituar. Mësymja e forcave serbe kundër forcave të rrethuara rezultoi në një nga humbjet më të mëdha të ushtrisë serbe në Luftën Ballkanike. Njëmijë e tetëqind ushtarë serbë që tentuan të hynin në qytet për të mbjellë vdekjen, u vranë nga forcat shqiptare e turke dhe shumë të tjerë u zunë rob. Serbia shpalli tri ditë zie kombëtare për atë humbje poshtëruese përballë Shkodrës.

Në qytetin e rrethuar zija e bukës ndërkohë kishte filluar të korrtë viktimat e para, dhe deri ditën e fundit të rrethimit çdo ditë kishte vdekje nga uria. Qëndresa heroike dhe e papritur e Shkodrës tashmë e kishte kthyer përfundimisht qëndrimin e Fuqive të Mëdha,^[3] sidomos të austriakëve të cilët megjithëse e dëshironin Shkodrën në kufijtë e Shqipërisë, kishin pranuar fillimisht që ajo t'i jepej Malit të Zi, duke e konsideruar pushtimin e qytetit nga malazetët një fakt të kryer. Nga mesi i muajit mars, shumica e popullsisë së rrethuar nuk kishte me se të ushqehet përveçse me “barishte, mëllaga, farë lini, kërmij, bretkosa, hithra e rrënjë barishtesh”, siç dëshmon një dëshmitar shqiptar i rrethimit.^[4] Ndërsa një gazetar italian, dëshmitar po ashtu, pohon se mijëra njerëz, shohin bukë me sy vetëm një herë në pesë apo gjashtë ditë. Vetëm më 11 prill ai numëroi 13 vetë të vdekur nga uria.^[5]

Në kushtet e një rrethimi të tillë, të një izolimi disamujor, ndërkohë që të rrethuarve nuk u mbërrinte asnjë ndihmë nga askush, pushtuesit kishin ndihma të panumërta. Kur vdekjet nga uria nisën të tejkalojnë vdekjet nga armët e betejës, komanda ushtarake e përbërë nga oficerë shqiptarë dhe osmanë, nën drejtimin e Esat Toptanit pas shumë diskutimesh e konsultimesh vendosi dorëzimin e qytetit jo si të humbur në luftë por për shkak të urisë. Shqetësimi kryesor i komandës ushtarake shqiptaro-osmane ishte evakuimi në siguri të plotë i forcave ushtarake mbrojtëse, përfshirë edhe vullnetarët e redifët (rezervistët) bashkë me armatimet e lehta e të rënda, dhe garantimi i jetës së popullsisë së krishterë dhe myslimane të qytetit e të rrethinave si edhe garantimi i paprekshmërisë së rriteve fetare dhe zakoneve kombëtare. Mbasi i pranuan këto kushte e garanci, mbas 6 muajsh rrethimi dhe qëndrese heroike, më 25 prill malazetët hynë në qytetin e ëndërruar. Megjithatë mbas tre javësh, më 14 maj, pikërisht për shkak të qëndresës heroike të forcave dhe popullsisë së rrethuar, ata u detyruan ta lëshonin Shkodrën përgjithmonë.^[6]

Për këtë luftë epike, një nga betejat

më të mëdha dhe më tragjike, por njëkohësisht fatlume, që është zhvilluar në historinë tonë, edhe sot mbas një shekulli nuk kemi ngritur asnjë monument përkujtimi. Nga ata mijëra të dëshmorë të asaj lufte heroike për shqiptari e liri, nga ata dhjetëra mijëra luftëtarë dhe të rrethuar që e ndërruan kahun e historisë, nuk përkujtohet askush, nuk është ngritur asnjë monument përkujtimi, asnjë ceremoni dhe as një nderim në këto 100 vjet shtet shqiptar. Jo vetëm kaq, por mbrojtësit heroikë të saj, historianë mendjelehtë i kanë shpallur tradhtarë, dhe mini-monumentin e Hasan Riza Pashës njerëz po aq mendjelehtë e kanë përdhosur

Lavdi të përjetshme shehidëve, ushtarëve dhe komandantëve që luftuan heroikisht dhe të gjithë të rrethuarve që qëndruan të paepur përballë shovinizmit të verbër!

[1] Deri edhe austriakët ishin të bindur se Shkodra do të binte pa filluar dimri dhe kishin pranuar mundësinë e kalimit të qytetit në favor të Malit të Zi. Ernst Christian Helmreich, The Diplomacy of the Balkan Wars (1912-1913), New York: Russell, 1969, f. 196.

[2] Cituar edhe nga Ilir Ikonimi, Esat Pashë Toptani. Njeriu, lufta, pushteti. UET Press, Tiranë, 2016, f. 52.

[3] Helmreich, The Diplomacy of the Balkan Wars, f. 196.

[4] Anonim, “Ditar, i rrethimit të Shkodrës”, Kumtari, nr. 7, f. 213.

[5] Gino Berri, L'assedio di Scutari: sei mesi dentro la città accerchiata. Diario di un corrispondente di guerra. Milano, Treves, 1913, f. 231.

[6] Një dokument që mban datën 13 maj dëshmon se malazetët të dëshpëruar nga hidhërimi i humbjes, ditët e fundit përpara datës së vendosur nga fuqitë e mëdha për largimin e forcave malazeze nga Shkodra, 350 dyqane i plaçkitën dhe më pas u vunë flakën. Jo vetëm kaq, por edhe ashtu siç ishin kujdesur që të shpallnin mbrojtësit e qytetit martir tradhtarë, dhe mbasi kishin vlarë mijra shqiptarë e shkatërruar qytetin më të lulëzuar të Shqipërisë së copëtuar, arrestonin disa shqiptarë duke i akuzuar gjoja për djegien e dyqaneve që i kishin plaçkitur e djegur vetë. The National Archives, (TNA), Foreign Office, 22061/24. Telegram i kont De Salis për Sir Edëard Grey. Cetinë 13 maj 1913.



Hasan Baftijari
teolog, Shkup

ZOT NA RUAJ NGA PËRÇARJA!

“Dhe mos u zini, dhe mos u grindni sepse do të dështoni, do të dobësohet forca juaj, por duroni se Zoti i do durimtarët.” - (Kur'an, El-Enfal: 46).

ra besimi, kur u dobësuan muslimanët, filluan ta shikojnë me dyshim këtë thënie të Profetit (a.s). Si vallë të bjerë miza në enën tonë dhe ne të mos e nxjerrim, por ta zhysim në të? Armiqtë e Islamit e shfrytëzuan këtë hadith, duke thënë: “Kjo është fé e papastërtisë.” Kjo gjë u bë sprovë. Dikush duroi dhe dikush ra në këtë sprovë.

Por, shkenca bashkëkohore, që ka hyrë në thellësitë dhe hollësitë më të mëdha, tregoi për vërtetësinë e fjalëve të profetit Muhammed (a.s). Shkencëtarët thonë, se kur miza i turret një ambienti uhor, flatra që afrohet është ajo që ka mikrobe, se mikrobet duan ujë, ndërsa tek flatra tjetër ka antimikrobe.

Me të vërtetë në pamje të parë të duket fé që nuk mjaftohet me një të hyrë të mizës, por duhet ta zhytësh edhe njëherë e pastaj ta nxjerrësh, ndërsa në realitet ajo është mrekullia vetë. Në

Allahu (xh.sh) për njerëzit, fé e përkryer që udhëzon njerëzit.

Po ne a jemi në nivelin e kësaj feje? A jemi pasqyrimi real i kësaj feje? A jemi imazhi i vërtetë i kësaj feje madhështore? Për fat të keq, shpeshherë muslimanët ftojnë kundër fesë së tyre. Shembulli i këtyre muslimanëve është tamam si një makinë e re, që nuk ka asnjë defekt, që është mjaft e bukur, por që keqpërdoret nga një shofer, që nuk e di vlerën e saj. Shoferi e shkatërron, e keqpërdor makinën dhe në fund fare njerëzit e shajnë makinën. Po çfarë faji ka makina? Fajin e ka shoferi, që e drejton gabim këtë makinë, fajin e kemi ne që e drejtojmë gabim këtë fé, e interpretojmë jo ashtu siç do Allahu (xh.sh).

Dua të pyes: “A jemi ne muslimanët e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Luginës së Preshevës, do të thoja

**ATË DITË PROFETI MUHAMMED (A.S) DHA SHPIRT DHE
NDËRROI JETË I LUMTUR, ME ZEMËR TË QËZUAR,
ME FYTYRË TË BARDHË PËRPARA ZOTIT, SEPSE I LA
MUSLIMANËT SI VËLLEZËR TË NJËRI – TJETRIT, DUKE
U FALUR PËRPARA MADHËSHTISË SË ALLAHUT (XH.SH).**

qoftë se nuk do ta derdhësh ujin, ngaqë mund të jetë vështirë për t'u gjetur, ose mund të jetë me pakicë, bëje këtë veprim, sepse është fjala e profetit (a.s). Është fjala e atij, i cili nuk gënjen, sepse flet me emrin e Allahut (xh.sh). Islami është fé madhështore, fé e zbritur nga

shqiptarët në përgjithësi ne që vëmë kokën në sexhde, imazhi real përpara muslimanëve të tjerë dhe përpara jomuslimanëve?” Kam frikë se shpeshherë ne bëhemi sprovë për të tjerët. Madje disa muslimanë arrijnë deri në atë pikë, sa kur të tjerët i shohin,

“O ZOT NA NXIRR NGA KJO SITUATË!

O ZOT MOS NA BËJ SPROVË PËR JOBESIMTARËT!

MOS NA BËJ ARMIQ TË NJËRI-TJETRIT, PO AFROJË ZEMRAT TONA”.

thonë: “Shyqyr që s’jemi muslimanë. Shiko se çfarë po bëhet! Muslimanët po hanë njëri-tjetrin, po përçahen, konflikti mes tyre sa vjen e shtohet”. Sot, sprova më e madhe për ne dhe për të tjerët është PËRÇARJA. Prandaj Zoti i gjithësisë e fton profetin Muhammed (a.s) dhe ne bashkë të lutemi me një dua (lutje): “O Zot, mos na bëj sprovë për jobesimtarët!” - (Mumtehine: 5).

Trishtohesh kur shikon muslimanë, që nuk i japin dorën njëri – tjetrit, që nuk flasin me njëri – tjetrin, vetëm për faktin se tjetri ka mendim të ndryshëm.

Ky është hendeku më i madh, është sprova më e madhe. Prandaj nuk kemi për ta lënë këtë fé të ngrejë krye, pa u bashkuar me njëri-tjetrin, pa e parë njëri-tjetrin në sy.

Ne na bashkojnë shumë gjëra e na ndajnë shumë pak gjëra. Profeti Muhamed (a.s), ai që e dinte rrezikun e përçarjes, ishte shumë i ndjeshëm. Ishte shumë kurioz të dinte hollësisht, se si besimtarët i kanë lidhjet me njëri-tjetrin dhe nuk falte aspak, nuk toleronte aspak, kur ata tentonin të përçaheshin njëri me tjetrin.

Profeti Muhammed (a.s) bashkoi dy fise të mëdha, Ausin dhe Hazrexhin, të cilët kishin luftuar me njëri-tjetrin për 400 vjet me radhë. Kishin rënë me mijëra e mijëra njerëz në këto luftëra, por deshi Zoti i gjithësisë, që këto fise u bënë muslimanë dhe u bashkuan në dorën e profetit Muhammed (a.s).

Në një nga betejat, ku merrnin pjesë muslimanët e Mekës dhe të Medinës, dy shërbëtorë, njëri nga fisi Aus dhe tjetri nga fisi Hazrexhu grindën me njëri-tjetrin. Ata ishin dy vëllezër muslimanë, dy sahabë të profetit Muhammed (a.s), por në grindje e sipër njëri i kërkoi ndihmë fisit të tij e po ashtu bëri edhe tjetri. Sapo e mori vesh këtë lajm, profeti Muhammed (a.s) u fut si vetëtimë mes tyre dhe thotë: “Kini frikë Allahun (xh.sh). A vazhdoni ende me sloganet e xhahilijes dhe të injorancës e unë jam akoma gjallë? Lërin këto slogane, lërin këto parime se atyre iu vjen erë e keqe!”

Vëllezër dhe motra!

Në një situatë të tillë ku gjendemi sot, unë ju ftoj që t'i kthehemi Allahut (xh.sh). Të kemi frikë Zotin e gjithësisë, të kemi turp prej Allahut (xh.sh), të kemi turp prej kësaj feje, se me të vërtetë po ia ulim vlerën asaj. U drejtohem të parëve të mi, atyre që flasin në emrin tim dhe në emrin tuaj, të kenë frikë Zotin e gjithësisë, t'i japin dorën njëri-tjetrit, të na afrojnë neve e të mos na shtyjnë. Jemi njerëzit, për të cilët do të përgjigjen përpara Allahut (xh.sh). Ftoj veten time dhe ju, që të mos shkaktojme përçarje, se kjo me të vërtetë është punë e shejtanit, punë e atij që kënaqet kur i shikon muslimanët larg njëri-tjetrit.

Le ta lusim Zotin e gjithësisë në sexhde me këtë lutje: “O Zot na nxirr nga kjo situatë! O Zot mos na bëj sprovë për jobesimtarët! Mos na bëj armiq të njëri-tjetrit, po afroji zemrat tona!”

Desha t'ju kujtoj vetëm me një moment, t'ju kujtoj me ditën e fundit të jetës së Muhammedit (a.s).

Ditën e fundit të jetës së tij, profeti Muhammed (a.s) s'mundi të dilte në xhami. Megjithatë ai hapi perden e dhomës së tij dhe i pa besimtarët duke falur namazin e sabahut, nën udhëheqjen e Ebu Bekrit (r.a). I pa të gjithë të bashkuar, në një drejtim, në një saf përkrah njëri-tjetrit, vëllezër para Zotit të gjithësisë, të lidhur përpara Allahut (xh.sh). Profeti (a.s) buzëqeshi dhe muslimanët gati sa nuk e prishën namazin nga gëzimi që po shihnin profetin e Zotit. Por, Profeti (a.s) u bëri me dorë që të vazhdonin. Atë ditë profeti Muhammed (a.s) dha shpirt dhe ndërroi jetë i lumtur, me zemër të qëzuar, me fytyrë të bardhë përpara Zotit, sepse i la muslimanët si vëllezër të njëri-tjetrit, duke u falur përpara madhësisë së Allahut (xh.sh).

E lus Zotin e gjithësisë që mëshira e tij të na përfshijë të gjithëve. E lus Allahun (xh.sh) që me të vërtetë ta kemi frikë madhëstinitë e Tij dhe në këto situata më shumë se kurrë t'i drejtohem Allahut (xh.sh), me përgjërime, që t'i bashkojë zemrat tona, të na afrojë tek njëri-tjetri, ta shikojmë njëri-tjetrin si vëllezër, me të cilët do të dalim përpara Tij.

Pesë vjet pa Hoxhën e zemrës..!



(17 maj 1923 – 19 shkurt 2013)

“Thotë All-llahu (xh.sh): “Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët!” - (Fatir: 28).

Thotë Profeti (a.s): “Dijetarët janë trashëgimtarët e Profetëve!” - (Ahmedi e shumë të tjerë nga Ebu Derda).

Me të vërtetë se të folurit për një dijetar nga dijetarët e ymmitit është shpalosje e një faqeje të ndritshme e të shkëlqyeshme nga faqet e dijes, besimit dhe punës së mirë, pasi e vërteta nuk mund të dalë në shesh vetëm se nëpërmjet përfaqësuesve të saj.

Dhe kur flas për Hoxhën e nderuar dhe dijetarin punëtor, vëllanë tim Hirësinë e Tij, Vehbi Sulejman Gavoçi, i cili e mori diturinë fetare nga shkollat e saj më të mëdha në botë, Ez’heri Sherif, them se ky dijetar edukator është argument në dije e njohuri si dhe shembull në misionin islam dhe në mirësjellje.

Hirësia e Tij Shejkh Gavoçi, është prej burrave të shkollës së reformës konform besimit të Ehli Synneti vel-Xhemaas, prej të parëve tanë të ndershëm, e mbron të vërtetën, punon për t’u realizuar e vërteta, punon në rrugën e vërtetë dhe shpreson tek shpërblimi i All-llahut, Të Vërtetit.

Prej virtyteve të Hirësisë së Tij, Shejkh Vehbi Gavoçi është edhe largimi nga fanatizmi, pasi ai ka jetuar në shoqëri të ndryshme islame në shumë prej vendeve, në të cilat ka punuar në mësimin e fesë dhe Thirrjen Islame.” - **Shejkh Ahmed Kefaro**



“EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)” - DR. MUHAMMED A. JEMANI

(LIBËR I PËRKTHYER NGA H. VEHBİ S. GAVOÇI - SHKODËR, 1996)

Gruaja e tij, Hatixhja, qe e para grua që besoi në fenë islame, ndërsa ndër burra, i pari ishte Ebu Bekri. Ndër fëmijë, Aliu qe i pari, e prej robërve, Zejdi. Pastaj ngadalë e pëlqyen këtë fëmijë njerëz të dobët e të varfër e pak pasanikë, ndërsa paria e vendit, pasanikët e njohur ngulën këmbë në terrin e tyre.

Kundërshtimet filluan, disa e vinin në lojë e qeshnin me të, të tjerë donin ta gënjenin me pasuri duke i thënë: "Të bëjmë pasanikun më të madh, të bëjmë kryetar e mbret, të japim më të bukurën grua, veç lëre fenë!" E kur edhe kjo mënyrë nuk vlejti, filluan përndjekjet, torturat e poshtërimet ndaj shokëve të tij, derisa e vranë Sumejen dhe atë e torturuan, madje deshën ta mbysin disa herë.

Kur erdhën disa njerëz prej Medines dhe pranuan Islamin, vetëm atëherë ai Zotëri lejoi shokët të emigronin në Medine Munevere. Porsa erdhi muaji Muharrem, filluan të emigrojnë tinëz natën për terr, vetëm ose grupe-grupe të vegjël, duke lënë pasurinë e vendlindjen, banesat e punën, në dorën e të pafeve, vetëm të jetojnë të lirë në besimin e tyre.

Paria e Mekës e kuptoi se duke ikur myslimanët nga vendi, një ditë edhe Muhammedi (a.s) do të vepronte në të njëjtën mënyrë, e kjo përbënte rrezik për ta. Prandaj u mblodhën në këshillin e tyre për të studiuar gjendjen e për të vendosur si të sillleshin me Profetin (a.s). Njëri tha: "Le ta dëbojmë Muhammedin nga Meka, le të shkojë ku të dojë, askush nuk e përkrah."

Ebu Xhehli u përgjigj: "Gabon ti, a e harrove gojën e ëmbël të Muhammedit e sjelljen e tij? Unë tutem, se po ta

dëbojmë, do të gjejë përkrahje prej arabëve të tjerë, me të cilët do të na luftojë. Jo, jo nuk pranohet ky propozim!"

Një tjetër tha: "Le ta burgosim këtu, e ta mbajmë në burg, derisa të vdesë. Me vdekjen e tij, zhdukim edhe besimin e tij."

Përsëri Ebu Xhehli u përgjigj: "Gabon, a harrove sa e duan shokët e vet? Nëse e burgosim, do ta thyejnë burgun e do të na luftojnë. Jo, nuk pranohet ky propozim!"

Një tjetër tha: "Pra, na trego ti, Ebu Xhehli, çfarë duhet të bëjmë? Ai dha këtë mendim: Të zgjedhim prej fiseve arabe nga një djalë të ri (ishin 16 fise). T'i japim secilit nga një shpatë të mprehtë. Sapo të dalë Ai Zotëri nga shtëpia e vet, ta sulmojnë bashkërisht e t'i bien nga njëherë me shpatat e tyre atij njeriu të bekuar. E kur të mendojë fisi i tij të marrë gjakun, do të përballet me 16 fise, kundër të cilëve nuk mund të luftojë dot. E kështu humb gjaku i të zgjedhurit të Zotit tek ata."

U pëlqeu ky propozim atyre krijesave të ulëta, rebele e gjakpirëse dhe menjëherë vendosën ta vënë në zbatim.

Të mjerët ata, nuk mendonin se duan të dëmtojnë të dashurin e Zotit, të cilit i ka premtuar mbrojtje dhe mbështetje në përhapjen e besimit islam. Zoti (xh.sh) i kallëzoi robët të Vet, Profetit (a.s) përmes Shpalljes se i kishte ardhur koha të emigronte, mbasi armiqësia kishte arritur në një shkallë të tillë të lartë e të rrezikshme.

Një ditë të nxehtë doli ai Zotëri nga shtëpia e vet në Mekë dhe shkoi tek Ebu Bekri e i tha: "Zoti (xh.sh) më ka lejuar të emigroj." Ebu Bekri i kërkoj që ta merrte me vete edhe atë, kështu që

Profeti (a.s) të kishte një shok për atë rrugë të vështirë. Kur Profeti pranoi, Ebu Bekri qau nga gëzimi se po emigronte me të dashurin e zemrës, pa menduar për rreziqet që mund t'i ndodhnin gjatë rrugës për në Medine. Caktuan kohën kur do të dilnin nga shtëpitë dhe vendin ku do të takoheshin.

Profeti i tregoi Hz. Aliut se do të emigronte së bashku me Ebu Bekrin, prandaj e porositi: "Ti fle në shtratin tim, mbulohu me mbulesën time, mos ki frikë, nuk mund të bëjë kush dëm. Nesër jep amanetet që kam lënë për armiq të që duan të më vrasin."

Kur erdhi koha, Profeti (a.s) doli prej shtëpisë pa u fshehur, pa u trembur, doli duke kënduar disa ajete të sures "Jasin": "Jasin (Ej njeri). Pasha Kur'anin e pacënueshëm në urtësinë e tij të lartë. S'ka dyshim se ti (Muhammed) je prej të dërguarve. Je në rrugë të drejtë. (Kur'ani është) Zbritje e të Plotfuqishmit, Mëshiruesit. Për t'ia tërhequr vërejtjen një populli, që të parëve të tyre nuk u është tërhequr e për atë shkak ata janë të hutuar. Për Zotin, tashmë ka marrë fund vendimi (thënia) kundër shumicës së tyre, andaj ata edhe nuk besojnë. Ne u kemi varë në qafat e tyre pranga e ato u arrijnë deri në nofulla, andaj ata mbesin me kokat lart. Ne u kemi vënë para tyre pendë e edhe mbrapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, andaj ata nuk shohin. Dhe për ata është e njëjtë, a ua tërhoqe vërejtjen, a nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë."

Ra nata, erdhën armiq të të kryenin krimin më të shëmtuar, të vrisnin Profetin e Zotit (xh.sh). Zoti ua mori sytë dhe i vuri në gjumë. Kështu kaloi Profeti para tyre pa e parë dhe pa e dëgjuar armiq të dhe për më tepër, u vuri pak dhe mbi krye të secilit.

Fjetën të mjerët deri në mëngjes. Kur lindi dielli, erdhi dikush dhe u kallëzoi se Profeti kishte dalë nga shtëpia e vet. Ata nuk besuan, deri sa panë që në shtrat ishte Aliu dhe jo Profeti (a.s). Luajtën mendsh armiq të dhe nuk dinin si t'ia bënin, mbasi shpëtoi ai Zotëri nga ai kurth i ndyrë. U shpërndanë andej-këtej me armë në dorë duke kërkuar e me në fund shpallën se kush e dorëzon atë Zotëri apo kryet e tij, do të shpërblehej me 100 deve, të cilat ishin një pasuri e madhe për atë kohë. Përhapën lajme nga të gjitha anët. Një varg i tërë ndjekësish shpërndahen andej e këtej në vise e krahina të ndryshme duke kërkuar çdo qoshe e skutë. Në malin Thour shohin një shpellë të vogël. Në atë shpellë pushonte Profeti me shokun e vet besnik. Ishte i lodhur ai Zotëri, prandaj ra në gjumë me kokë në prehrin e Ebu Bekrit. Ky e kishte pastruar shpellën, por një vrimë në tokë nuk e kishte mbyllur. Vuri këmbën në të. Ajo vrimë kishte patur një gjarpër brenda, që porsa e ndjeu erën e njeriut, nisi ta thumbonte. Ebu Bekri i qëndroi dhembjes dhe nuk e lëvizi këmbën nga vendi, që të mos trazonte Profetin (a.s).

Mirëpo nga dhembja i rrodhën lotët dhe i ranë mbi fytyrë të Profetit, i cili u zgjua nga gjumi. E mori vesh ngjarjen, i hapën vrimën gjarpërit dhe e mbytnë.

Mbas pak kohe erdhën disa kalorës armiq. Ata hipën mbi shpellë, ku ishte ai Zotëri, por nuk ua mori mendja kurrë se mund të ishte kush brenda. Një merimangë kishte endur pëlhurën e vet në grykë të shpellës dhe një pëllumb kishte ndërtnuar çerdhen pranë saj.

Kur dëgjoi Ebu Bekri se dikush ishte sipër shpellës, përmbyti ta, tha: "O Profet, po frikësohem se mund të shohin gjurmët tona e kështu do të na njohin."

Profeti iu përgjigj me qetësi: "Mos u trishtohet! Ne nuk jemi vetëm. Zoti është me ne." Armiq të u kthyen në shtëpitë e veta pa asnjë fitim, madje edhe pa shpresë.

Mbas tri ditësh Zotëria doli nga shpella dhe së bashku me shokun e vet, Ebu Bekrin e një udhërrëfyes që iu solli devetë, u nisën për në Medine. Ecnin natën e pushonin ditën për t'u mbrojtur, që të mos i shikonin armiq të.

Qëlloi, që një arab i quajtur Suraka, djali i Malikut, po rrinte në fushë me disa shokë. Pau dy deve prej së largu dhe e kuptoi se ata mund të ishin njerëzit për të cilët ishte shpallë shpërblimi e duke i kapur gjallë a vdekur, mund të fitoheshin 100 deve. U largua tinzisht nga shokët, i hipi kalit dhe i armatosur u

Të mjerët ata, nuk mendonin se duan të dëmtojnë të dashurin e Zotit, të cilit i ka premtuar mbrojtje dhe mbështetje në përhapjen e besimit islam. Zoti (xh.sh) i kallëzoi robët të Vet, Profetit (a.s) përmes Shpalljes se i kishte ardhur koha të emigronte, mbasi armiqësia kishte arritur në një shkallë të tillë të lartë e të rrezikshme.

drejtua nga pau rrugëtarët. Kur u afrua, e pau Ebu Bekri dhe tha: "O Profet, po na afrohet një kalorës." Ai Zotëri as që shikoi andej, por iu lut Zotit (xh.sh). Menjëherë kali i Surakës ra në një gropë e kalorësi u rrëzua për tokë. U përpoq edhe njëherë t'i ndiqte, por menjëherë këmbët e kalit u fundosën në rrëzë deri në gjunjë. Kështu e kuptoi se nuk qe punë fati, por ai njeri që donte ta dëmtonte, ishte vërtetë Profet. Në këto çaste thirri: "Ja Muhammed, me lejo të afrohem ku je ti dhe ke paqe prej meje." U afrua Suraka tek ai Zotëri, e përshëndeti si arabët e vjetër.

Profeti i propozoi Islamin e i tha: "Si thua ti, kur të vijë dita, që Islami të rrëzojë perandorinë persiane, a do të pranosh të veshësh ti bylyzykët e Kirsasë (të parit të persëve)?" Suraka u habit se si ky njeri që fshihej nga ndjekësit, në këto çaste kishte shpresë aq të mëdha.

Suraka i kërkoj Profetit një besë që, në se mblidhte fiset arabe në fenë islame, të mos dëmtohej fisi i tij. Profeti ia dha besën dhe vazhdoi rrugën e emigrimit me shokun e vet, ndërsa Suraka, kur takonte dikë rrugës, i thoshte se ai Zotëri kishte kaluar dhe nuk e arrinte dot kush.

Në rrugë Profeti u ndesh me axhën e vet, tregtar Abasin, i cili po kthehej nga Siria. Ai i fali të nipit dhe shokut të tij nga një palë rroba.

Kur arriti Profeti (a.s) afër Medines, një njeri i hipur mbi një kullë, priste ardhjen e tij, si arabët e tjerë. Sapo e pa Profetin, thirri me zë të lartë: "Ej, banorë të Medines, erdhi fati juaj!"

Kur arriti në Kubá, kishin dalë ta prisnin burrat me fëmijë, vajza e djem, emigrantë e vendali të gëzuar e të qeshur, të veshur me rrobat më të mira e me armët më të shtrenjta. Këndonin vjersha e këngë e mbi të gjitha dëgjohej "Himni i pritjes në Medine."

Ndërsa Profeti arriti në Medine,

Suraka nuk u kthye në shtëpinë e vet te fisi i tij, por shkoi në Mekë, ku deklaroi pranimin e fesë islame dhe me vjershë i kallëzoi Ebu Xhehli: "Ej, baba i Hakemit, betohem se sikur të ishe aty e të shihje atë gjendje të kalit tim, kur i hynë gjunjët në rrëzë, do ta kuptoje dhe nuk do të dyshojë se Muhammedi është Profet. Kush qëndron para tij, e kupton këtë me fakte. Ndaloje popullin tënd, mos t'i bëjë keq atij si unë."

Vërtetë, Profeti ka ndritur si hëna botën në ditën që lindi dhe si hënë e plotë (15 ditësh), kur u shpall Profet; ai i erdhi njerëzimit me besim të saktë, e shpëtoi atë nga errësira e politeizmit dhe e shkatërrimit duke ndritur me dritën islame.

Profeti ka qenë yll udhërrëfyes për zemrat e myslimanëve, atëherë kur u kthye ngadhënjyes dhe fitues kundër romakëve në Tebuk.

Qe një ditë e shkëlqyer ajo kur hyri në Mekë me 10 mijë luftëtarë dhe rrëzoi putnat (idhujt) brenda e jashtë Qabes. Atë ditë u foli të gjithë armiqve të vet të tubuar para Qabes: "Çka mendoni se do të bëj me ju, tani që jeni të mundur? Njëri prej tyre u përgjigj: "Mendojmë mirë, se je vëlla e djali i vëllait të ndershëm."

Ai Zotëri u gëzua dhe u foli kështu: "Nuk ju qorto, nuk ju ndëshkoj, shpërndahuni, të gjithë jeni të lirë."

Kush, kush sillet në këtë mënyrë me luftëtarët e zënë rob? Askush.

Zemrat tona ndiejnë gëzim e krenari, kur vjen rasti e përmendet ai Zotëri që na ndriçon rrugën e na jep pëlqimin e Zotit (xh.sh) në të dy jetët tona.

Lum si ne, lum njerëzimi me atë njeri që thotë: "Unë jam mëshirë e dhuruar." Për të vetë Zoti ka thënë: "Nuk të kemi dërguar, veçse mëshirë për mbarë botët."¹

1. Kur'ani, El-Enbija: 107.





Arben Halluni, teolog

KRENARIA E SHPIRTIT

"E tërë krenaria i takon Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë!" - (El-Munafikunë:8)

Krenaria shpirtërore e ka burimin te Krijuesi i gjithësisë, Allahu (xh.sh). I takon vetëm Madhërisë së Tij t'i paraprijë. Prej kësaj krenarie hyjnore bën pjesë edhe profeti Muhamed (a.s) dhe besimtarët e devotshëm. "E tërë krenaria i takon Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë!" - (El-Munafikunë:8)

Me besim të paluhatshëm, adhuroj të sinqertë e me nënshtrim të drejtë, larg politeizmit, besimtarët kanë mundur të krenohen para të gjitha krijesave. Sa herë që besimtari ka thelluar nënshtrimin ndaj Allahut dhe madhërisë së Tij absolute i është shtuar besimi te vetja dhe është njohur me mundësinë e kufizuar të tij. Lidhja e besimtarit me Krijuesin është dëshmi e qartë se i krijuari nuk mund t'i nënshtrohet krijesave të ndryshme, sado të mëdha të jenë, ose çfarëdo pozite të kenë, sepse çdo krijesë që ne e shohim, apo nuk e shohim e adhuron Allahun (xh.sh) me mënyrën e caktuar. "E nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbihë), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre." - (El-Isra: 44)

Teuhidi (monoteizmi) do të thotë njësueshmëri në besim e adhuroj; do të thotë lirim i shpirtit të njeriut nga besëtytnitë, kulti i individit, arroganca dhe superioriteti; do të thotë pajisje me etikën e rezistencës, të durimit, të sakrificës dhe të shpirtit të devotshëm. Të gjitha këto veti morale janë vlera madhështore që burojnë nga një pozicion, e ky është pozicioni i teuhidit absolut të Krijuesit të gjithësisë.

Besimtari kur njeh Zotin e tij refuzon që t'i nënshtrohet tjetër kujt. Për të nuk ka zot tjetër, e as të adhuroj tjetër, dhe si rrjedhojë nga kjo burojnë sjelljet morale të këtij besimtari. E para: nga sjelljet morale është krenaria shpirtërore, e cila është e domosdoshme të jetë në çdo shtresë njerëzore, qoftë i pasur apo i varfër, qoftë i fortë apo i dobët, qoftë sundues apo i sunduar. Një sjellje e tillë morale ka qenë natyra e mirëfilltë që ka shoqëruar vazhdimisht sahabët (shokët) e profetit Muhammed (a.s), i cili ua mësoi moralin e lartë dhe u mori besën që të jenë gjithmonë të kapur pas krenarisë së tyre shpirtërore, të mos i nënshtrohen krijesës, sido që të jenë situatat, të vështira apo të lehta. E rëndësishme ishte të ruaje parimin etik islam. Transmetohet nga Ebi Abdurrahman Auf Bin Malik (r.a.), i cili ka thënë: "Ishim tek i Dërguari i Allahut afërsisht nëntë vetë. Ai na tha: "A nuk i jepni besën të Dërguarit të Allahut?" - Shtirimë dorën dhe i thamë: "Të dhamë besën, o i Dërguar i Allahut, por mbi çfarë do të qëndrojmë besnik?" - Ai tha: "Të adhuron Allahun dhe të mos

i bëni atij shirk (politeizëm-besimi në shumë zotëra), të falni pesë namazet e detyruara, t'i nënshtroheni vetëm Krijuesit të gjithësisë dhe mos u lypni njerëzve..." - (Transmeton Muslimi)

Profeti Muhammed (a.s) në këtë hadith fisnik ka përcaktuar disa elemente kryesore si: Besimi në një Zot të vetëm, i cili e liron njeriun nga shirku (besimi në shumë zotëra), kryerja e namazeve të ditës që janë dukuri të adhimit ndaj Krijuesit të merituar, nënshtrimi i sinqertë, i cili nuk mund të kundërshtojë asesi urdhrat e Allahut (xh.sh) dhe fryti i të gjithë elementëve të lartpërmendur është që besimtarët të ruajnë veten e tyre nga lypja tek njerëzit.

Besimtarët që janë të pajisur me edukatën islame, me virtytet e paqes dhe harmonisë me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit (xh.sh) e që janë të kapur pas urdhrave të Tij dhe që krenohen me krenarinë e Zotit të tyre, janë po ata që nuk ndiejnë varfëri edhe pse mund të jenë të varfër, nuk ndiejnë dobësi edhe sikur të jenë në të vërtetë të dobët. Atyre pa dyshim u hijeshohet dhe u zbukurohet pamja e lodhur dhe pranimi i kënaqësisë së caktuar nga Zoti Fuqiptotë. Pikërisht për këta, që preokupim kryesor kanë vetëm rrugën e Allahut (xh.sh), Krijuesi i gjithësisë na ka urdhëruar që t'u gjendemi afër ekonomikisht dhe shpirtërisht dhe t'u ndihmojmë në rast nevojë. Allahu (xh.sh) në Kur'anin Famëlartë ka përkrahur këtë shtresë në mënyrën më të përsosur: "(jepni) Për të varfrit që janë të

"S'ka dyshim se tek Allahu më i nderuar ndër ju është ai që ia ka frikën (është i përkushtuar ndaj Allahut...) - (El-Huxharatë:13)
Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s) thotë:
"Nuk është i pasur ai që ka shumë pasuri, por i pasur është ai që ka shpirtin të pasur".

angazhuar në rrugën e Allahut dhe nuk kanë mundësi të gjallërojnë me tokë, duke qenë se ata nuk lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur. Ata i njeh nga vetë pamja e tyre (të rraskapitur), por nuk kërkojnë e as nuk mërzhisin njerëzit. Pra çkado që të jepni nga pasuria, s'ka dyshim se atë Allahu e di shumë mirë." - (El-Bekare: 273)

Nga ana tjetër, shumë njerëz mendojnë se krenaria nuk vjen ndryshe, vetëm pas ngopjes së barkut dhe mbushjes së xhepit. Ka të pasur që mundohen të mbledhin pasuri dhe ta zotërojnë atë vetëm për veten e tyre, pa i dhënë të drejtë që të shijojnë një pjesë të saj shtresave nevojtare, me qëllim që të jenë krenarë jo nga ana shpirtërore por nga ana materiale, si kundër ka të varfër që me varfërinë e tyre nënçmohen dhe nënshtrohen me dëshirën e tyre. Kësisoj sjelljes, që nuk sjellin progres, por regres, janë të përhapura shumë në shoqëritë e ndryshme bashkëkohore. Janë të përhapur të pasur arrogantë dhe mendjemëdhenj, ashtu siç janë të përhapur të varfër gënjeshtarë dhe që mbështeten vetëm në servilizëm. Kjo ndarje në të pasur arrogantë e në të varfër hipokritë shpie në konflikt shtresash dhe si rrjedhojë shkatërrimi i njërës, apo tjetrës ose të dyjave, për shkak të luftës dhe mosmarrëveshjeve meskine në shpirtitrat e dobët. Këto mund të quhen edhe grupe të liga prej të cilave përfitojnë fraksionet materialiste.

Feja Islame distancohet vazhdimisht nga këto grupe të devijuara, të cilat e bëjnë preferencën apo dallueshmërinë

në mes robërve mbi bazën e materies së shuar e stolisjeve të përkohshme. Ndërkaq, Kur'ani i Shenjtë dënon koncepte dhe aplikime të tilla. "Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë. Për shkak se e ndien veten të pavarur. Po kthimi është vetëm te Zot yt." - (El-Alak:6-8). Jo vetëm kaq, por besimi islam ka apeluar se baza e dallueshmërisë midis krijesave njerëzore ngrihet mbi etikën e lartë që është devotshmëria: "S'ka dyshim se tek Allahu më i nderuar ndër ju është ai që ia ka frikën (është i përkushtuar ndaj Allahut...) - (El-Huxharatë:13) Ndërsa i Dërguari i Zotit Fuqiptotë thotë: "Nuk është i pasur ai që ka shumë pasuri, por i pasur është ai që ka shpirtin të pasur".

Ka shumë njerëz që e quajnë veten të pasur kur zotërojnë shumë sende në këtë botë, por realisht i pasur është ai që ka shpirtin të pasur dhe është krenar për këtë mirësi madhështore dhuruar nga Krijuesi i gjithësisë. Mjerisht ka njerëz që e grumbullojnë pasurinë, e fshehin atë e nuk e përdorin, se frikësohen se mos e humbin. Pra janë bërë skllavër të pasurisë në vend që ajo të jetë skllave e tyre. Pasuria ka vlerën kur përdoret vetëm për të mirën e njerëzimit në shërbim të fesë e të vendit. Ndonjëherë, vëmë re se shumë prej nesh të cilëve Allahu (xh.sh) u ka dhënë pasuri të mëdha hezitojnë ose shmangen të ndihmojnë në projekte fetare e sociale, se frikësohen se mos u pakësohet, ndërsa ata që kanë më pak janë më bujarë dhe japin pa kursim, pse janë të pasur në shpirt dhe si rrjedhojë kanë të drejtë të krenohen me shpirtin e tyre të pasur.

Pa dyshim se profeti Muhamed (a.s) në të gjitha etapat e kësaj jete materiale ka qenë krenar në veten e tij, nuk ka shtrirë dorën para askujt, përveç Allahut (xh.sh), Furnizuesi i pakufishëm. Pas tij, erdhën sahabët të cilët çdo gjë të nevojshme e kërkuan me krenarinë shpirtërore, sepse e dinin se çështjet ecin sipas kaderit. Ata ruajtën çdo mësim e edukatë që ua mësoi i Dërguari i Zotit (xh.sh) dhe e përcollën tek brezat e ardhshëm, të cilët janë përgjegjës që ta ruajnë dhe ta aplikojnë këtë moral të lartë deri në fund të kësaj jete lëndore. Transmetohet nga Sehl Bin Sead se: "Erdhi një herë Xhibrili tek Profeti (a.s) dhe i tha: "O Muhammed, jeto sa të duash se do vijë dita që do të ndërrosh jetë, dije se fisnikëria e besimtarit është në faljen e namazit të natës dhe krenaria e tij është kur nuk ka nevojë për njerëzit."

Do ta kisha vizituar me shumë qejf Shkodrën, ani pse e dija se komunizmi i kishte shkatërruar xhamitë...



"E kisha provuar të vija në Shqipëri në 1974, kur vizitova Kosovën dhe ndenja atje tre muaj, por kur kërkoja të hyja në kufi me Shqipëri nga Prizreni, nuk më lejuan të hyja në vendin tim... por megjithatë unë nuk e mora inat Shqipërinë, pavarësisht se komuniste...

Do ta kisha vizituar me shumë qejf Shkodrën, ani pse e dija se komunizmi i kishte shkatërruar xhamitë...

Ne shqiptarët jemi njerëz të mirë, shumë të mirë dhe në Siri kemi ndërtuar gjysmën e Sirisë... Ne shqiptarët kemi ndërtu shtetet e tjera, po duhet me e ndërtu Shqipërinë mor djema.

Shqipëria është e bukur dhe e ka fal Zoti (xh.sh) me vende të bukura. Pse me e shkatërroi na shqiptarët si në '97?

Jam pikëlluar në 1997 dhe që atëherë s'kam ardh ma në Shqipëri, por du me ardh se jam plak e du me e pa për her të fundit Shqipërinë dhe Shkodrën..."

Hoxha i jonë, H. Vehbi S. Gavoçi (1923 - 2013)

"E nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbihë), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre". - (El-Isra: 44)



EGJIPTI

“Hyni në Egjipt, me lejen e All-llahut, të sigurt prej çdo të keqeje.” – (Jusuf: 99)

“Kijeni frikë All-llahun në koptët e Egjiptit! Ju do të fitoni mbi ta, e pastaj ata do të jenë mbështetësit dhe ndihmëtarët tuaj në rrugën e Zotit.” – (Taberaniu)

“Ju do ta merrni një vend ku përmendet “kirati”, prandaj silluni mirë me banorët e tij, sepse me ta na lidh miqësia dhe gjaku...” – (Muslimi)

Egjipti është një nga vendet, që njihet për qytetërimin e tij të lashtë. Mjafton si nderim për Egjiptin kur themi se në atë tokë kanë shkelur shumë nga të Dërguarit e Allahut, si: Idrisi (a.s), Ibrahim (a.s), Jusufi (a.s), Musai (a.s), Haruni (a.s), Isai (a.s) me nënën e tij Merjemin (a.s). Deri në ditët tona Egjipti njihet si djepi i dijetarëve.

Egjipti është vendi ku jepte mësim Idrisi, vendi që vizitoi Ibrahim, vendi ku u formua dhe u burrua Jusufi, vendi ku lindi dhe u rrit Musai dhe Haruni, vendi që strehoi Isain me nënën e tij në ditë të vështira...

Egjipti është vendi, që përmendet me emër në Kur'anin Famëlartë, kur Jusufi (a.s) pati thënë: “Hyni në Egjipt, me lejen e Allahut, të sigurt prej çdo të keqeje.” – (Jusuf: 99)

Egjipti është vendi, që e lavdëroi i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kur pati thënë: “Kijeni frikë All-llahun në koptët e Egjiptit! Ju do të fitoni mbi ta, e pastaj ata do të jenë mbështetësit dhe ndihmëtarët tuaj në rrugën e Zotit.” – (Taberaniu)

Egjipti është vendi të cilin e gjallëron një lum i bekuar, lumi i Nilit, për të cilin i Dërguari i Allahut pati thënë: “(Natën e Israsë) M'u zbulua pema Sidretul-Munteha, dhe aty pashë katër lumenj: dy lumenj të dukshëm dhe dy lumenj të

fshehur. Dy të dukshmit janë Nili dhe Eufrati, kurse dy të fshehurit janë dy lumej në Xhenet.” – (Buhariu)

POZITA GJEOGRAFIKE DHE POPULLSIA E EGJIPTIT

Egjipti është një vend trans-kontinental, ku pjesa më e madhe e tij shtrihet në skajin veri-lindor të kontinentit afrikan, ndërsa një pjesë e tij, Sinai, shtrihet në kontinentin e Azisë.

Në anën veriore, Egjipti kufizohet me detin e Mesdheut, në anën verilindore kufizohet me Palestinën, në lindje me Detin e Kuq, në jug me Sudanin dhe në perëndim me Libinë.

Egjipti ka një sipërfaqe prej 1.002.450 km², me një popullsi prej rreth 96.400.000 banorësh. (www.capmas.gov.eg/). Kryeqyteti i tij është Kajro, një nga qytetet më të mëdha të vendit dhe me dendësinë më të madhe të popullsisë.

Nga ana administrative, Egjipti është i ndarë në njëzet e shtatë qytete. Egjipti është republikë demokratike dhe autoriteti legjislativ kryesohet nga Dhoma e Përfaqësuesve. Shumica e popullsisë është e përqendruar rreth lumit Nil. Gjuha zyrtare është gjuha arabe. Shumica e popullsisë i përket fesë islame sunite, rreth 94. 2%. Të krishterët përbëjnë rreth 5.78% të popullsisë, ndërsa pjesa tjetër i përkasin fesë hebraike, si dhe pakica

të tjera.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI HISTORINË E EGJIPTIT

Historia e Egjiptit daton që nga viti 3200 (p.e.s), kur u themelua nga mbreti Mina, i cili bashkoi Mbretërinë e Veriut me atë të Jugut. Gjatë kohës së tij lulëzoi civilizimi faraonik, dhe u formua një qeveri qendrore. Në këtë kohë u shpik shkrimi me hieroglifë, u zhvillua bujqësia, arti, industria dhe tregtia.

Epoka e shtetit modern të Egjiptit filloi rreth vitit 1580 (p.e.s), kur mbreti Ahmus i parë e mundi Heksosin dhe e dëboi nga vendi. Kjo epokë karakterizohet për fokusimin në forcimin e aftësive ushtarake në mbrojtje të kufijve të shtetit, gjë që çoi në krijimin e ushtrisë dhe rivendosjen e sigurisë e stabilitetit në vend.

Më vonë, Aleksandri i Madh i dëboi persianët nga Egjipti, pasi i mposhti në territorin e Azisë së Vogël. Egjipti iu nënshtrua sundimit të Ptolemejve në vitin 333 (p.e.s), dhe vazhduan ta sundojnë atë deri në vitin 30 (p.e.s). Periudha e sundimit të tyre u dallua për ndërtimin e tempujve, si tempulli Dendera, si dhe për ndërtimin e një biblioteke të madhe e cila përmbante më shumë se gjysmë milioni fletushka.

Romakët e sunduan Egjiptin që nga viti 30 (p.e.s), e deri në vitin 641. Nën sundimin e tyre, Egjiptit ishte i famshëm



për industrinë e lirit, letrës, parfumi, qelqit, dhe mjeteve të dekorimit.

Myslimanët e morën Egjiptin në vitin 641, e deri në ditët tona Egjipti, është një vend Islam.

EGJIPTI ISLAM

Në vitin 641, në kohën e halifit Omer ibn el-Hatab (r.a), Egjiptin e morën myslihanët, nën udhëheqjen e komandantit Amr ibn el-As.

Që më përpara, i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, e kishte paralajmëruar se myslihanët do ta merrnin Egjiptin: “Ju do ta merrni një vend ku përmendet “kirati”, prandaj silluni mirë me banorët e tij sepse me ta na lidh miqësia dhe gjaku...” – (Muslim)

Dijetarët e shpjegojnë se lidhja e gjakut është për shkak se Haxheri, nëna e profetit Ismail (a.s), ishte egjiptiane, kurse lidhja e miqësisë ishte për shkak se Maria, një robëreshë e të Dërguarit të Allahut (a.s) dhe nëna e djalit të tij, Ibrahimit, gjithashtu ishte egjiptiane.

Amr ibnul-As e kishte vizituar Egjiptin kohë më përpara kur kishte ardhur për tregti aty. Pastaj më vonë, nën kalifatin e Omer ibnul-Hatabit, Amr ibnul-As ia kishte paraqitur disa herë Omerit (r.a) mendimin e tij për ta marrë Egjiptin, derisa Omeri kishte pranuar.

Me një ushtri prej katër mijë vetash, Amr ibnul-As mori rrugën për në Egjipt. Pas disa luftërave të ashpra, që zhvilloi me romakët bizantinë që sundonin atëkohë Egjiptin, ai arriti fitoren.

Amr ibnul-As zgjodhi një vend pranë kështjellës së Babilonisë, në perëndim të malit Mokattam, për të ndërtuar qytetin e tij të ri, të cilin e quajti Fustat, që do të thotë “tendë”, sipas tendës së

tij që e kishte vendosur aty. Pastaj, në mes të qytetit Fustat, ai ndërtoi xhaminë e parë në Egjipt, që ishte edhe xhamia e parë në të gjithë Afrikën, “Xhamia Amr ibnul-As.”

Kur u ndërtua për herë të parë, kjo xhami kishte gjashtë porta, me një pjesë të çatisë të pa mbuluar. Kolonat e saj të brendshme ishin me palma, ndërsa për pjesën e çatisë që u mbulua, u përdorën degë palmash.

Në mesin e ushtrisë së tij thuhet se ishin tetëdhjetë sahabë, prej tyre: Zubejr ibnul-Avam, Mikdad ibnul-Esved, Ubade ibnus-Samit, Ebu Derda, Ebu Dherr El-Gafariu, Abdullah ibn Omer ibnul-Hatab, Abdullah ibn Amr ibnul-As, e të tjerë, Allahu qoftë i kënaqur prej atyre të gjithëve!

Në xhaminë e Amrit zhvilloheshin mësimet të fikhut islam, dhe dëgjuesit rrinin ulur rreth mësuesit, i cili ulej mbështetur në një nga shtyllat e palmave.

Nga mësuesit më të njohur prej sahabëve, pas hapjes së Xhamisë, ka qenë Abdullah bin Amr ibnul-As, që njihet edhe si themeluesi i shkollës fetare Islame në Egjipt, prej të cilit morën mësim shumë prej banorëve vendas.

Që atëherë e deri sot, Egjipti ka qenë vendi i mirësisë dhe i dijetarëve.

Atje është universiteti i tret më i vjetër në botë, Universiteti i Az'herit, i cili e filloi rrugëtimin e tij si vatrë e dijes që në vitin 970. Prej tij kanë dalë dhe vazhdojnë të dalin dijetarë të Islamit dhe të të gjitha fushave të tjera të dijes e të shkencës.

Arta Ujkaj, teologe



100 VJET NGA NDËRRIMI JETË I SULTAN ABDULHAMID HANIT

10 shkurt 2018, dita e 100 vjetorit të ndërrimit jetë të Prijësit të besimtarëve, njërit prej halifëve më të fortë të Islamit, njërit prej politikanëve dhe ekonomistëve më mendjemprehtë në epokën bashkëkohore, Sulltan Abdulhamid Hani, All-llahu e mëshiroftë, e lartësoftë gradën e tij dhe e shpërbleftë për mbarë ymetin islam!

Laikët u përpoqën ta mbulojnë dhe errësojnë biografinë e tij, mbështetur edhe nga orientalistët dhe lëvizjet nacionaliste, duke e cilësuar si gjakatar dhe të padrejtë.

Fshehën dokumentet që nxjerrin në pah të vërtetat! Por, një ditë e vërteta do të dalë në pah, duke triumfuar!

Akoma sot, përkujtimi i tij u prish rehatinë, teksa frikësohen se mos ringjallet historia e tij! Rahmet pastë!

(Me përshtatje nga gjuha arabe: Muhamed B. Sytari, nga faqja zyrtare e studiuesit skrupuloz: Dr. Murhaf Sekka)

AKTIVITET ARSIMOR DHE ARGËTUES MES NXËNËSVE TË XHAMIVE KULLAJ DHE DRAGOÇ

Të dielën, më 04 shkurt 2018, Myftinia Shkodër përmes sektorit të arsimit organizoi në xhaminë Kullaj aktivitetin e radhës me temë: “Të mësojmë dhe të argëtohem” me nxënësit e kësaj xhamie dhe nxënësit e kurseve fetare të xhamisë Dragoç.

Në këtë aktivitet drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, gjatë takimit me nxënësit u mbajti një bisedë fetare, ku u foli për vlerën që ka zhvillimi i mësim-besimit, për njohuritë kryesore të Islamit dhe për edukimin e brezave sipas frymës tradicionale islame, besimit dhe moralit që duhen të karakterizohen me përkushtimin ndaj Zotit xh.sh, dashurinë dhe harmoninë më të gjithë njerëzit dhe krijesat e Tij.

Teologu Halluni falënderoi mësuesit dhe njëkohësisht imamët e dy xhamive, Kullaj dhe Dragoç, Ardin Selhani dhe Shkëlqim Sykja për angazhimin e vazhdueshëm në edukimin e brezave të ri si dhe për gjallërimin e xhamive me veprimtari të ndryshme islame.

Sipas programit të aktivitetit u zhvillua një konkurs fetar në bazë të njohurive të larmishme që marrin gjatë procesit mësimor, biseda në mes nxënësve, shëtitje si dhe lojëra sportive.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR QENDRËN E RE ISLAME

Paraditën e së enjtes, më 8 shkurt 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt dhe vëllazëror, z. Korab Kaja, Drejtor i Fondacionit “Mirësia”.

Gjatë këtij takimi, Myftiu falënderoi z. Kaja për kontributet e vyera të Fondacionit “Mirësia”, sidomos në fushën e ndërtimit të xhamive të reja, ku falë këtij bashkëpunimi, gjatë viteve të fundit janë ndërtuar disa xhami në Shkodër, si: në Kuç, në Domën, në Kullaj, në Mjedë, në Krye-Bushat, në Dudas dhe tani në lagjen Draçin.

Qëllimi i këtij takimi ishte nënshkrimi i marrëveshjes për ndërtimin e një qendre të re islame në fshatin Oblikë, që do të ketë një rëndësi të veçantë për besimtarët dhe rininë muslimane të Anës së Malit.



Qendra Islame në fjalë është pjesë e kompleksit të ri islam që nisi me rindërtimin e xhamisë në qendër të Anës së Malit.

Nga ana e tij, z. Korab Kaja falënderoi

Myftiun dhe Myftininë e Shkodrës për frymën e bashkëpunimit dhe theksoi se projekte të tilla kanë një vlerë të madhe për komunitetin dhe rimëkëmbjen e aktivitetit fetar e kulturor në vend.

PROMOVHET LIBRI: “40 HADITHE ME NGA DY POROSI”, I TEOLOGUT LAVDRIM HAMJA

Mbrëmjen e së xhumasë, më 9 shkurt 2018, në bibliotekën e qytetit, Myftinia Shkodër organizoi promovimin e librit “40 Hadithe me nga dy porosi”, të teologut Lavdrim Hamja.

Aktivitetin e hapi teologu Arben Halluni, i cili pasi i uroi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre bëri një prezantim të shkurtër të botimit të kolanës me “40 Hadithe”, sjellë në gjuhën shqipe nga teologu Lavdrim Hamja dhe redaktuar nga Imam Muhamed Sytari.

Më pas e mori fjalën Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili pasi falënderoi autorin për librin e ri, ndër të tjera tha: “Seria e katërt e kolanës së dyzet haditheve, të përzgjedhura, përkthyer e përshtatura prej tij në gjuhën shqipe, është një risi e bukur dhe plot dobi në historinë e botimeve islame në gjuhën shqipe. Është një risi, që pasqyron më së miri atë, që vetë autori thekson në parathënien e botimit të tij të ri: “Nuk ka dyshim, se pa e njohur jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s), apo siç quhet ndryshe në terminologjinë islame, Synetin e tij, nuk mund ta ndjekim e ta pasojmë në vepra, në moral dhe sjellje.”

Pikërisht, nëpërmjet kësaj vepre të vogël në dukje, lexuesi mund të përfitojë njëherazi 80 porosi të urta nga burimi i urtisë së Hz. Muhamedit (a.s). Sidomos sot, kur propaganda islamofobe, edhe në gjuhën shqipe dhe në trojet tona, mundohet të bëjë rolin e zhurmuesit dhe penguesit të pamoralshëm para duarve të rinisë dhe masës së gjerë, leximi i këtyre haditheve dhe i këtij model botimesh, mendoj se ka një rëndësi dhe vlerë të



madhe në drejtim të pastrimit të imazhit të gabuar të krijuar rreth Islamit, si dhe në drejtim të përfuturit të vlerave reale të fesë sonë, nga burimi i të Dërguarit të All-llahut!”

Më pas, teologu Idmir Plaku, në analizën e tij u ndal tek titulli i librit, ku theksoi se ky titull ka qenë në traditën e hershme të dijetarëve myslimanë, të cilët i gruponin hadithet e Pejgamberit (a.s) në tematika të ndryshme.

Gjithashtu, ai u ndal edhe tek disa hadithe të veçanta të këtij botimi, duke sjellë për të pranishmit dhe njëkohësisht edhe për lexuesit, vlerën e fjalës së Profetit (a.s).

Në fund e mori fjalën edhe autori i këtij libri, teologu Lavdrim Hamja. Në fjalën e tij, teologu Hamja, në lodhje me traditën e të Dërguarit të Allahut (a.s), ndër të tjera tha: “Sigurisht që kjo traditë

është e gjerë dhe gjithëpërfshirëse, e ndoshta myslimani e ka të vështirë, apo të pamundur të arrijë ta njohë, ta lexojë, ta studiojë e ta zbatojë të gjithën.

Prandaj, gjëja më e bukur dhe më e mirë, do të ishte përzgjedhja dhe ndalimi tek ato pjesë, që janë më parësore dhe më mundura për tu zbatuar. Në fakt, ky ka qenë edhe qëllimi jonë, për të sjellë në gjuhën shqipe, fillimisht, pjesën parësore të Traditës Profetike.

E kam filluar me “40 Hadithe për mirësinë e diturisë”, pastaj me “40 Hadithe për mirësinë e agjërimit dhe të Ramazanit”, pastaj me “40 Hadithe për mirësinë e Kur’anit” dhe libri që sot po promovojmë, “40 Hadithe me nga dy porosi”.

Në përfundim të këtij promovimi, për të pranishmit u bë edhe shpërndarja e librit: “40 Hadithe me nga dy porosi”.



IMAMËT DISKUTOJNË NË PRAG TË KONFERENCËS SË 7-TË VJETORE

Paraditën e mërkurë, më 21 shkurt 2018, imamët dhe teologët e Shkodrës zhvilluan një takim pune në prag të konferencës së 7-vjetore të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës.

Në këtë takim u diskutua për temën e konferencës së sivjetshme, e cila do të ketë si temë kryesore të saj "Familjen e shëndoshë islame". Ata ishin të mendimit se sfidat e mëdha me të cilat po përballët institucioni i familjes në këtë kohë, kërkojnë një angazhim maksimal nga ana e imamëve, për t'i orientuar njerëzit drejt rrugës së Islamit, që është mbrojtja më e mirë e familjes dhe shpëtimi i saj.

Çdo familje, e cila që në formimin e saj, ngrihet mbi parimet e fesë islame, është e mbrojtur prej sfidave shkatërruese dhe probleme të ndryshme të kohës – thanë ndër të tjera imamët.



**"E kush është
NË RRUQË MË TË MIRË SE
AI QË THËRRET
NË RRUQËN E ALLAHUT,
QË BËN VEPRA TË MIRA
dhe QË THOTË: UNË JAM
prej MYSLIMANËVE?"**

(Kur'ani, Fussilet: 33)



THIRRJE PRESIDENTIT ERDOĞAN NGA GUTA LINDORE

Kuvendi komunal në Gutën Lindore, rajon i cili mbahet nën rrethimin e regjimit të Bashar Asadit në Siri, i ka bërë thirrje presidentit të Turqisë Recep Tayyip Erdoğan për përfundimin e sulmeve dhe rrethimit dhe për parandalimin e një katastrofe më të madhe humanitare në këtë vend, transmeton Anadolu Agency (AA).

Kuvendi komunal në Gutën Lindore, përmes një deklarate me shkrim ka shprehur kërkesë te presidenti turk Erdoğan.

Në deklaratë thuhet se regjimi i Asadit dhe milicët e mbështetur nga Irani, përkrahës të regjimit, janë në përgatitje të një sulmi më të madh.

Duke theksuar se rethimi i cili ka vazhduar për më shumë se pesë vite është duke shkaktuar efekte negative dhe të përhershme sidomos te fëmijët dhe gratë. Në deklaratë vihet në dukje se avionët e regjimit dhe Rusisë janë duke sulmuar me armë të llojllojshme qendrat vitale dhe spitalet.

"Në emër të kuvendeve lokale në zonën rurale të kryeqytetit Damask, ne ju bëjmë thirrje juve, meqë jeni me ndikim te komuniteti islam dhe bota ndërkombëtare, që të ndërhyet në mënyrë

urgjente për mbrojtjen e fëmijëve dhe të bëhet presion ndaj regjimit dhe milicëve iranianë, mbështetës të tyre.

Ne si populli i Gutës Lindore dëshirojmë që të ndërhyet në mënyrë urgjente. Ne po ju presim ju me shpresë që të thyhet rrethimi i regjimit, për ofrimin e lehtësimeve për hyrjen e ndihmave humanitare dhe për parandalimin e katastrofës humanitare", thuhet në deklaratë.

400 mijë civilë të bllokuar

Guta Lindore, rajon i kontrolluar nga opozitarët, ndodhet vetëm dhjetë kilometra larg qendrës së Damaskut, kryeqytetit sirian të kontrolluar nga regjimi i Asadit.

Përmes një marrëveshjeje në Astana, Guta Lindore ishte shpallur zonë e deeskalimit. Megjithatë, pjesëtarët e regjimit të Asadit, vend garantues i të cilit është Rusia, nga muaji prill i vitit të kaluar intensifikuan rrethimin, ndërsa muajt e fundit edhe sulmet.

Rajoni prej 104 kilometrash katrorë në lindje të Damaskut është bërë skenë e katastrofës më të madhe të luftës civile. Rreth 400 mijë civilë, prej të cilëve gjysma fëmijë, prej pesë vitesh jetojnë nën rrethimin e regjimit, duke u përballur



me kequshqyerje, mungesë barnash dhe sulme intensive.

Mijëra civilë të sëmurë presin të evakohen urgjentisht nga rajoni në të cilin kriza humanitare është thelluar. Shumica e të sëmurëve janë fëmijë ose persona që vuajnë nga kanceri në fazë të avancuar. Shumë foshnja dhe fëmijë në Gutën Lindore kanë humbur luftën për mbijetesë për shkak të urisë dhe mungesës së barnave.

Në tri ditët e fundit, regjimi ka vrarë më shumë se 250 civilë në Gutën Lindore dhe ka goditur 22 spitale.

(www.aa.com.tr)

MUSLIMANJA ME SHAMI ZGJIDHET DEPUTETE NË KATALONIA



Muajin e kaluar një grua muslimane është zgjedhur të jetë pjesë e Parlamentit të Katolonisë.

Najat Driouech së bashku me dy myslimanë të tjerë janë përfaqësues në

asamblenë prej 135 vetave.

Ajo ishte e 10-ta në listën e partisë Republikane të Majtë që janë pro pavarësisë, e cila ka 32 deputetë të zgjedhur.

Driouech ka punuar mbi 17 vite si konsulent për integritet në Masnou, afër Barcelonës. Ajo ka thënë: "Qëllimi im nuk është të jem gruaja e parë muslimane e parlamentit, por të jem e para e shumicës së femrave".

Ajo ka migruar nga Maroku në Spanjë në moshën 9 vjeçare. I ka thënë BBC-së se ajo e ka ndier diskriminimin çdo ditë. "Kur je e vogël dhe flet gjuhën katalanese dhe Spanjolle, njerëzit thonë "sa e ëmbël". Por kur rritesh, e fillon të flasësh dhe të debatosh gjëra, e kjo nuk pritet mirë. Tani më je një rival".

Për momentin në Katoloni jetojnë më shumë se 500,000 mijë muslimanë, duke bërë 6.8% të popullatës.

(www.radiokontakt.al)

**I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S)
KA THËNË:**

**"ALL-llahu i Madhëruar
dëshiron, që kur
ndonjëri prej jush
ta bëjë një punë,
ta përsosë atë."**

Bejhakiu
nga Nëna e jonë, Aishe (r.a)



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:



**"Më e mira
e punëve është:
NAMAZI në kohën e tij
dhe MIRËSJELLJA
ndaj PRINDËRVE".**

(TRANSMETUAR NGA MUSLIMI)

www.myftinia-shkoder.org



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org